



Republika e Kosovës



Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Në bazë të nenit 12.2 “d” dhe 40.2 “c” të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L-040, dhe nenit 41.2 “ç” të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më **30.04.2012**, mori këtë:

V E N D I M

Për plotësimin dhe ndryshimin e Vendimit 01 Nr.17/12

Neni 1

Me këtë vendim përmirësohet vendimi i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë 01.Nr.17/12, të datës 26.01.2012 për bartjen e mjeteve të pashfrytëzuara nga të hyrat vetanake, nga viti 2011 në vitin 2012.

Neni 2

Ndryshimet sipas nenit 1 të këtij vendimi bëhen me sa vijon:

2.1 Shuma e mjeteve të bartura në programin e pagave dhe mëditjeve (kodi 111), në vend të shumës 31,978.08 €, **bëhet shuma 31,978.80 €;**

2.2 Shuma e mjeteve të bartura – mallra dhe shërbime (kodi 130), në vend të shumës 133,977.39 €, **bëhet shuma 125,025.19 €.**

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Kryesuesi i Kuvendit

Ferit Idrizi



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtri

Në bazë të nenit 17 "c" të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L-040, nenit 5, pikat 1,3 dhe 6 të Ligjit për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës Nr.03/L-226 dhe të nenit 40.2 "k" të Statutit të Komunës së Vushtrisë, si dhe në bazë të kërkesës së Stacionit Policor në Vushtri, Kuvendi i Komunës së Vushtrisë në mbledhjen e mbajtur më **30.04.2012**, mori këtë:

V E N D I M

Për dhënie në shfrytëzim të përkohshëm pa kompensim të tokës në pronësi të komunës

Neni 1

Me këtë vendim ipet në shfrytëzim të përkohshëm pa kompensim, në afat deri në 40 vjet toka në pronësi të komunës, pjesë e parcelës kadastrale **P-70202053-00573-2**, certifikata e pronësisë **UL-70202053-00059**, në sipërfaqe prej **900 m²**, ZK- Prelluzhë, MPB, Stacionit Policor në Vushtri, për vendosjen e kontejnerëve për nevojat e nënstacionit policor në Prelluzhë.

Neni 2

Vendosjen e kontejnerëve të cekur në nenin 1 të këtij vendimi, do ta financon Ministria e Punëve të Brendshme.

Neni 3

Komuna e Vushtrisë mbetet pronare legjitime e tokës të përcaktuar në nenin 1 të këtij vendimi.

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit dhe Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrisë.

Kryesuesi i Kuvendit

Ferit Idrizi



Republika e Kosovës



Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Në bazë të nenit 11, 12 dhe 14 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L-040, si dhe nenit 41.2 “ç” të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më **30.04.2012**, mori këtë:

V E N D I M

Për rrënimin e objektit të komunës, rregullimin e hapësirës dhe vendosja e shtatores “Hasan Prishtina”

Neni 1

Me këtë vendim lejohet rrënimi i objektit të komunës, rregullimi i hapësirës dhe vendosja e shtatores “Hasan Prishtina” në rr. “Adem Jashari” nr.1, përkatësisht në pronën e komunës, e evidentuar në certifikatën e pronësisë **UL-70202016-00045**, me kulturë “shtëpi-ndërtesë”, në sipërfaqe prej 453 m² dhe “oborr” në sipërfaqe prej 1071 m², gjithsej 1524 m², si dhe **P-70202016-00666-0**, me kulturë “shtëpi-ndërtesë”, në sipërfaqe 312 m², dhe “oborr” në sipërfaqe prej 87 m², gjithsej 399 m², në sipërfaqe të tërësishme 1923 m².

Neni 2

Obligohet Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit që në bashkëpunim me drejtoritë tjera kompetente të komunës të zbatojë procedurat ligjore për rrënim të objektit të përcaktuara në nenin paraprak.

Neni 3

Mjetet financiare për rrënimin dhe rregullimin e hapësirës në fjalë do të planifikohen me buxhetin e vitit 2013.

Neni 4

Obligohet Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit që të zbatojë procedurat për projektin e rregullimit të hapësirës në të cilën do të përfshihet ndërtimi i shtatores së “Hasan Prishtinës”, dhe t’ia paraqes projektin në fjalë për shqyrtim dhe miratim në njërin nga mbledhjet e kuvendit të komunës.

Neni 5

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtorja për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, Drejtorja për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtorja për Buxhet dhe Financa, dhe sipas nevojës edhe drejtoritë tjera kompetente të komunës.

Neni 6

Ky vendim hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrisë.

Kryesuesi i Kuvendit

Ferit Idrizi



Republika e Kosovës



Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Në bazë të nenit 6 të Ligjit për planifikim hapësinor nr. 2003/14, nenit 5 të Ligjit nr.03/L-106 për ndryshimin e Ligjit për planifikimin hapësinor nr.2003-14, nenit 12.2 “d” të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 dhe nenit 40.2, pika “1” të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më **30.04.2012**, mori këtë:

V E N D I M

Për emërimin e Bordit Këshillëdhënës për hartimin e planeve rregulluese urbane

Neni 1

Me këtë vendim emërohet Bordi Këshillëdhënës për hartimin e planeve rregulluese urbane për qytetin dhe Komunën e Vushtrrisë, në këtë përbërje:

- Menderes Ibra, kryetar i bordit;
- Ruzhdi Pllana, zv. kryetar;
- Arsim Gërzhaliu, arkitekt;
- Musa Vatovci, arkitekt;
- Nexhmedin Melenica, inxh. i ndërtimtarisë;
- Bajram Xhafa, gjeodet;
- Bojana Aritonovic.

Neni 2

Detyra e Bordit Këshillëdhënës është që të jep këshilla, mendime dhe sugjerime gjatë të gjitha fazave të hartimit të planeve rregulluese urbane, i cili përfshin zonat përgjatë magjistrales Prishtinë-Mitrovicë, përkatësisht nga fshati Smrekonicë deri në fshatin Gracë, duke përfshirë të dy anët e magjistrales dhe zonat e përfshira sipas planit zhvillimor urban nr. 7, 6, 8, 9, 10, 11, 13, 14, 16, 17, 4, 5, 12 dhe 15.

Neni 3

Për punën e tij, Bordi Këshillëdhënës do të kompensohet me vendim të veçantë të aprovuar nga kuvendi i komunës.

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit

Neni 5

Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet vendimi i kuvendit të komunës 01 Nr 14/12, dt. 26.01.2012.

Neni 6

Ky vendim hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrisë.

Kryesuesi i Kuvendit

Ferit Idrizi



Republika e Kosovës



Kuvendi i Komunës-Vushtri

Në bazë të nenit 12.2 pika "d" të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 Udhëzuesit për formimin e këshillit të ekspertëve të planifikimit të datës: 04.11.2004 nenit 41.2 pika "ç" të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në seancën e mbajtur më **30.04.2012**, mori këtë:

V E N D I M

Për kompensimin e Bordit Këshillëdhënës për dhënien e këshillave për hartimin e planeve rregulluese urbane

Neni 1

Me këtë vendim kompensohet puna e Bordit Këshillëdhënës në fjalë.

Neni 2

Bordi Këshillëdhënës për punën e tij do të kompensohet nga buxheti i komunës, në lartësi prej 50 € për çdo mbledhje.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Kryesuesi i Kuvendit

Ferit Idrizi



Republika e Kosovës



Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Në bazë të nenit 14.2 dhe 17 "c" të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, dhe nenit 40.2 "k" të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më **30.04.2012**, mori këtë:

V E N D I M

Për anulim të vendimit 01 Nr.162/11, dt. 24.02.2011

Neni 1

Me këtë vendim anulohet vendimi i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë 01 Nr.162/11, dt. 24.02.2011, për dhënien në shfrytëzim të përkohshëm pa kompensim të tokës në pronësi të komunës, në afat prej 5 (pesë) viteve, me mundësi vazhdimi, e cila është pjesë e parcelës kadastrale **P-70202043-00110-0**, certifikata e pronësisë **UL-70202043-00036**, në sipërfaqe prej 1000 m², ZK-Nedakoc, për ndërtimin e një qendre edukuese bujqësore, për zhvillimin e aktiviteteve të IADK-së (Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës).

Neni 2

Anulimi i vendimit të cekur në nenin 1 të këtij vendimi bëhet pasi që marrësi në shfrytëzim të pronës komunale është tërhequr nga investimi i paraparë.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.

Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit dhe nënshkrimit nga kryesuesi i kuvendit.

Kryesuesi i Kuvendit

Ferit Idrizi



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Në bazë të nenit 11, 12 dhe 17 “c” të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L-040, dhe nenit 41.2 “ç” të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, si dhe në bazë të dispozitave të Rregullores së KK-së 01 Nr.139/11, dt. 30.06.2011, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më **30.04.2012**, mori këtë:

V E N D I M

Për caktimin e lokacionit për shërbimet me auto-merimangë

Neni 1

Me këtë vendim caktohet lokacioni për kryerjen e shërbimeve me auto-merimangë (auto-park) në ngastrën kadastrale **P-70202043-00110-2**, me kulturë “oborr” me sipërfaqe prej 1000 m² dhe **P-70202043-00110-3**, me kulturë “oborr” me sipërfaqe prej 1234 m², me sipërfaqe të përgjithshme prej 2234 m², ZK-Nedakoc, pronë e Komunës së Vushtrrisë.

Neni 2

Certifikata pronësore dhe kopja e planit janë pjesë përbërëse e këtij vendimi dhe të bashkangjitura në shtojcë.

Neni 3

Kryerja e shërbimeve me auto-merimangë do të bëhet konform Rregullores për shërbimet e transportit me auto-merimangë në Komunën e Vushtrrisë.

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë dhe Drejtoria për Shërbime Publike.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Kryesuesi i Kuvendit

Ferit Idrizi



Republika e Kosovës



Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Në bazë të nenit 12.1 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale 03/L-040, si dhe nenin 40.2 “ç” të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më **30.04.2012**, mori këtë:

V E N D I M

Për shfrytëzim të mjeteve të fondit stimules të USAID-DEMI

Neni 1

Mjetet e fondit stimules të USAID-DEMI në shumë prej 25.000 \$, të cilat në këtë vit iu janë ndarë Komunës së Vushtrrisë për transparencë për vitin 2011, destinohen për blerjen e lloptopëve për anëtarët e kuvendit të komunës, dy zyrtarët e sekretarisë, si dhe blerjen e një aparati për skanim të materialeve, për nevojat e Sekretarisë së KK-së.

Neni 2

Në rast se shuma e mjeteve të cekura në nenin paraprak nuk është e mjaftueshme për destinimin e cekur, mjetet e nevojshme për këtë qëllim do të sigurohen nga buxheti i komunës.

Neni 3

Nga dita e pajisjes së anëtarëve të kuvendit me lloptop, dërgimi i materialeve për mbledhjet e kuvendit të komunës dhe të KPF-së do të bëhet në mënyrë elektronike nga Sekretaria e Kuvendit.

Neni 4

Anëtarët e kuvendit të komunës, përkatësisht ata të KPF-së në ditën e mbajtjes së mbledhjeve duhet të posedojnë lloptopët, në mënyrë që diskutimet për materialet të cilat janë në rend të ditës të mund të zhvillohen nga materialet të cilat iu janë dërguar në mënyrë elektronike nga Sekretaria e Kuvendit.

Neni 5

Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Sekretaria e Kuvendit, USAID-DEMI, dhe sipas nevojës edhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

Neni 6

Ky vendim hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrisë.

Kryesuesi i Kuvendit

Ferit Idrizi



Republika e Kosovës



Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Në bazë të nenit 8.1, 8.2 dhe 8.3 të Ligjit për Arsim në Komunitet e Republikës së Kosovës Nr.03/L-068, nenit 12.1 dhe 17 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale 03/L-040, si dhe nenit 41.2 “ç” të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më **30.04.2012**, mori këtë:

V E N D I M

Për shfrytëzimin e mjeteve të fondit stimulues të USAID-DEMI

Neni 1

Mjetet e fondit stimulues të USAID-DEMI në shumë prej 45.000 \$, të cilat në këtë vit iu janë ndarë Komunës së Vushtrrisë për performancë më të mirë të shërbimeve komunale, përkatësisht kategoria “rrugët, trotuarët, ndriçimi publik” destinohen për projektin “rregullimi i oborrit dhe ndërtimi i rrethojës të shkollës fillore dhe të mesme të ulët në fshatin Bukosh” (vlera e projektit: 28.182,04 €), dhe shkollës fillore në fshatin Smrekonicë (vlera e projektit: 19.802,75 €).

Neni 2

Në rast se shumica e mjeteve të cekura në nenin paraprak nuk është e mjaftueshme për destinimin e cekur, mjetet e nevojshme për këtë qëllim do të sigurohen nga buxheti i komunës.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Arsim, USAID-DEMI, dhe sipas nevojës edhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Kryesuesi i Kuvendit

Ferit Idrizi